

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Artan Sejrani, me anëtarët Xheladin Osmani e Nazim Vllaço si anëtar të trupit gjykues, me procesmbajtësen Florije Kolukaj, në lëndën penale kundër të akuzuarve J.G, L.G dhe A.G që të tre nga fshati ..., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 parag. 3 lidhur me parag. 1 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.22/2017 të datës 29.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. F.J, av. E.G dhe av. H.K që të tre nga Prizreni, me datën 09.10.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. J.G, nga i ati R.. dhe e ëma E., e lindur ..., i lindur me dt. ..., në Pejë, tani me banim në fshatin ..., Komuna e Pejës, i pa martuar, punëtor në ndërtimtari, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

2. L.G, nga i ati R.. dhe e ëma E., e lindur ..., i lindur me dt. ..., në Pejë, tani me banim në fshatin ..., Komuna e Pejës, i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3. A.G, me nofkën "...", nga i ati M., e ëma A., e lindur ..., i lindur me dt. ..., në Pejë, tani me banim në fshatin ..., Komuna e Pejës, i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

JANË FAJTORË

Se duke vepruar si anëtar të grupit me përdorim të forcës kanë përvetësuar pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që ti sjellin vetës dobi pasurore të kundër ligjshme në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake në mes veti, me datën 16.02.2017 nga Peja me automjetin e tipit "Fiat Punto", me ngjyrë hiri metalike pronë e Kompanisë Renta car "...", vinë në Prizren dhe aty rreth orës 22:55 minuta, të maskuar me kapulaça të jakneve të vendosura në kokë, me shall të mbështejllura në fytyrë dhe me dorëza të holla të vendosur në duar, se bashku me shpejtësi hynë në barnatoren "...", në rrugën "..." pn, në Prizren, i akuzuari J.G me grusht e then xhamin e recepturës (banaku), pastaj kalon përmbi banak të hapësira ku ishte e dëmtuara B.Ç. të cilës ia kap flokët, ia merr nga dora telefonin celular dhe i thotë "ku janë paratë" dhe pasi ia tregon fiokën e dëmtuara, nga aty i merr me shpejtësi rreth 750 euro, i akuzuari L.G gjatë gjithë kohës ka pasur në dorë pistoletën të drejtuar kah e dëmtuara, ndërsa i akuzuari A.G në dorë e kishte satrën (sëpatën e vogël)

duke qëndruar te dera e lokalit dhe vëzhguar situatën deri sa i akuzuari J.G i ka marrë nga fioka parat e pastaj me shpejtësi që të tre ikin nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur.

- Këso dore kanë kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 parag. 3 lidhur me parag. 1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21, 33, 41, 42, 43, 45, 46, 69, 73, 74, 83, 273 para. 2 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i :

GJYKON

- Të akuzuarin **J.G**, me dënim me burg në kohëzgjatje **prej 8 (tetë) vite**, dhe me dënim me **gjobë në shumë prej 500 (pesëqindtë) €**, të cilin dënim është i obliguar të paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- Të akuzuarin **L.G**, me dënim me burg në kohëzgjatje **prej 8 (tetë) vite**, dhe me dënim me **gjobë në shumë prej 500 (pesëqindtë) €**, të cilin dënim është i obliguar të paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- Të akuzuarin **A.G**, me dënim me burg në kohëzgjatje **prej 8 (tetë) vite**, dhe me dënim me **gjobë në shumë prej 500 (pesëqindtë) €**, të cilin dënim është i obliguar të paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- Nëse të akuzuarit nuk mund apo nuk dëshirojnë të paguajnë dënimet me gjobë, të njëjtat do të zëvendësohen me dënime me burg ashtu që çdo 20 € të dënimit me gjobe do të llogaritet një ditë burgu.
- Pala e dëmtuar B.(A.) Ç. nga Prizreni rr. “...” nr. ... dhe A.T nga Prizreni rr. “...” nr. ... (barnatore), për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.
- Obligohen të akuzuarit, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë paushallin gjyqësor secili në lartësi me nga 300 (treqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.22/17 të datës 29.03.2017, kundër të akuzuarve J.G, L.G dhe A.G që të tre nga fshati ..., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 parag. 1 lidhur me parag. 3 të KP-së.

Prokurori i shtetit Metush Biraj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se para se të paraqes fjalën përfundimtare dëshiroj që ta rregulloj pikën 2 të aktakuzës dhe atë në rreshtin e parë, ku para fjalës me përdorim të kanosjes... duhet të ekzistoj fjala duke vepruar si anëtarë të grupit, ndërsa pjesa tjetër ngelet e pa ndryshuar. Për ndryshe konsideron nga provat që janë administruar gjatë gjykimit e sidomos përmes deklaratës

bindëse të të dëmtuarës si dëshmitare B.Ç. dhe pas shiqimit të bërë përkatësisht administrimit të provës të CD-së ku është incizuar ngjarja në barnatoren "...", me pa mëdyshje është vërtetuar teza e aktakuzës se i akuzuari J.G ka kryer veprën penale grabitje nga neni 329 parag. 1 lidhur me parag. 3 te KP-së, dhe të akuzuarit L.G dhe A.G kanë kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 parag. 1 lidhur me parag. 3 të KP-së, në mënyrën si më afërsisht të përshkruar në këto dy pika të aktakuzës i akuzuari J.G duke përdorur forcën kurse të akuzuarit L. dhe A.G duke përdorur kanosjen serioze kanë sulmuar trupin apo jetën e viktimës. Prandaj mbrojtjet e të akuzuarve se kinse nuk janë sulmuar trupin apo jetën e viktimës, apo se kinse nuk janë kryerës të kësaj vepre penale gjykata nuk do ti merr parasysh nga se ato mbrojtje janë aq të tejdukshme ku shihet mirëfilli se të njëjtit me mbrojtje që kanë paraqitur në seancën kryesore kanë qëllim për te ju shmangur përgjegjësisë për veprat e kryer penale. Për ndryshe nga deklaratat e të akuzuarve dhënë në polici apo ne prokurori para mbrojtësve të tyre ne mënyre pedante dhe të përpikte i kanë përshkruar mënyrën apo modus operandin të kryerësve të veprave penale. Prandaj gjykatës i propozoj që të akuzuarit të shpallën fajtorë për veprat të kryer penale të gjykohen ne bazë të ligjit. Me rastin e caktimit të dënimit gjykatës i propozon që prej rrethanave renduese të ketë parasysh peshën e veprës penale e sidomos rrethanat në të cilat të akuzuarit e kanë kryer ketë vepre penale e sidomos shkallën e përgjegjësisë së tyre, faktin se të akuzuarit edhe me parë kanë kryer vepra penale të kësaj natyre qoftë ne Pejë dhe në Prishtinë, kur për një vepre konkrete të grabitjes nga gjykata themelore ne Prishtinë janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar, kurse prej rrethanave lehtësuese duhet të ketë parasysh se të akuzuarit megjithatë janë të moshës së re.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.G – av. F.J, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me qëllim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës fjalën e tij përfundimtare e ka përgatitur për të mbrojturin e tij këtu J.G duke e përmbledhur në formë të shkruar dhe nga një kopje ia ka dorëzuar trupit gjykues po ashtu edhe prokurorit. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka potencuar sipas aktakuzës së paraqitur të prokurorisë themelore në Prizren – departamenti për krime të rënda PP/I nr. 22/17 te datës 29.03.2017, i akuzuari J.G akuzohet se ka kryer veprën penale grabitje nga neni 329 parag. 1 lidhur me parag. 3 te KP-së. Sipas përshkrimit faktik të veprës penale në aktakuzën e paraqitur, pranë të cilës përfaqësuesi i aktakuzës ka ngelur në tërësi edhe në fjalën e fundit, J.G “ që duke vepruar si anëtar i grupit, me përdorim të forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që ti sjellë vetës dobi pasurore të kundër ligjshme, në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake me të akuzuarit tjetër me datën 16.02.2017, nga Peja me automjet, i maskuar me kapulaç në kokë rreth orës 22:55 minuta, hynë në barnatore “...” në Prizren, me grushte e then xhamin e banakut ...”. Pas fjalës përfundimtare të përfaqësuesit të aktakuzës, rrjedhë se aktakuza e paraqitur ka ngelur në tërësi e pa ndryshuar, si në aspektin e përshkrimit faktikë, ashtu edhe cilësimit juridik të veprës penale, me të cilën ngarkohen të akuzuarit, edhe i mbrojturi im, J.G. Si që shihet nga formulimi i pjesës ku jepet përshkrimi faktik i veprës, aktakuza është konfuze dhe e pakuptimtë, nuk kemi asnjë të dhënë, provë. Edhe dispozitivi i aktakuzës është në kundërshtim me vetë vetën dhe arsyet e dhëna lidhur me faktet vendimtare. Nga provat e administruara dhe faktet e vërtetuara, sidomos të shiqimit të CD-së, në sallë të gjykimit në kamerën 02 të datës 17.02.2017 rreth orës 00:25:21 sec. Shihet se tre persona hynë në barnatore, i pari i cili ka hyrë në barnatore i drejtohet banakut dhe thyen një xham të banakut, personi i dytë i veshur me të zeza i cili është i maskuar shihet se në dorë ka diçka, personi i tretë është të dera e hyrjes, personi i parë futet në banakë e hapë fiokën dhe nga

aty merr diçka, personi i cili në dorë kishte diçka, shihet se në dorë ka një armë dhe që të dy persona i afrohen farmacistes e cila ishte duke punuar, personi i cili ishte në banak, shihet se nga farmacistja merr një telefon dhe nga fijoka merre ca gjëra, dhe që të tre persona largohen nga vendi me shpejtësi. Mbrojtja në lidhje me këtë provë materiale ka patur vërejtje në rrethanën që pas shiqimit me vëmendje të këtij video incizimi, si në ambientet e zyrës së avokatit, ashtu edhe gjatë shqyrtimit nuk kemi mundur të bëjmë identifikimin e personave të shfaqur në video, në raport me të mbrojturin tim. Për rrjedhojë, me asnjë veprim të tij rreth grabitjes në natën kritike në barnatore e asnjë rrethanë tjetër, nuk i përgjigjen veprimit konkretë të këtij të akuzuari me të cilën konsiderohet se është kryer vepra. Kjo vepër penale nuk është vërtetuar, sepse i mbrojturi im dhe të akuzuarit të tjerë, pavarësisht në procedurën hetimore ka pranuar përgjegjësinë për kryerjen e vepër në fjalë, në shqyrtimin kryesor një gjë të tillë kanë mohuar të ketë kryer dhe nuk ka marrë përgjegjësinë për këtë vepër, duke deklaruar se në kohën kritike nuk ka qenë fare në Prizren, por ka shkuar në male për të prerë dru. Dispozitivit të aktakuzës, i mungojnë elementet dhe figurat e veprës penale të grabitjes duke vepruar si anëtarë i grupit, madje edhe me kushte që i mbrojturi im të ketë pranuar fajësinë, gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike do të duhej të identifikonte veç e veç secilin person nga video incizimi, i propozuar si provë materiale nga prokurori. Prandaj gjykata nuk ka arritur të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar kryerjen e veprave penale nga këtu i akuzuari J.G. Prokuroria ka dështuar të argumentoj se cili i akuzuar cilat veprime konkrete ka kryer në grabitjen e supozuar, si nga i mbrojturi im dhe të akuzuar tjetre, sepse nga CD e shikuar në asnjë rrethanë nuk është arritur që të bëhej identifikimi i personave të shfaqur aty dhe që ka të bëjë me të mbrojturin tim, duke përshkruar veprimet inkriminuese. Së këndejmi mbrojtja konsideron se i mbrojturi i tij nuk i ka kryer këto veprime të pretenduara inkriminuese sipas akuzës së prokurorit të shtetit. Andaj ajo që u tha me lartë, pa dyshim konkludohet se i akuzuari J.G nuk i ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet, prandaj edhe propozojmë që ai, në bazë të nenit 364 pika 3 të KPP-së, të lirohet nga aktakuza.

I akuzuari J.G në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën e mbrojtësit të tij dhe se nuk ka çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.G – av. E.G, ka deklaruar se fjalën përfundimtare e ka përgatitur me shkrim të cilën ia dorëzon trupit gjykues e cila do të jetë pjesë përbërëse e procesverbalit. Nëse trupi gjykues e gjen se i mbrojturi im është kryerës i veprës penale atëherë të ketë parasysh rrethanat lehtësuese që të caktoj një dënim sa më të butë, për shkak se është në kufi të moshës së personave të mitur. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka theksuarës bazuar në provat të cilat prokuroria i ka paraqitur dhe administrimin e të njëjtave nuk mund të konstatojmë se L.G është kryerës i kësaj vepre penale nga se nga shiqimi i CD-së në shqyrtimin kryesor nuk ka qenë e mundur të bëhet identifikimi i të akuzuarit L.G se ka qenë kryerës i kësaj vepre penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës së Prokurorisë. Pavarësisht pranimit të fajësisë në polici dhe në prokurori në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari L.G e ka kundërshtuar aktakuzën dhe provat të cilën e mbështesin atë. Si mbrojtës i caktuar sipas detyrës zyrtare shprehi vullnetin dhe dëshirën e tij në bazë të këtij vullneti dhe si mbrojtës e kundërshtojë akuzën dhe provat të cilat janë administruar, kërkoj nga gjykata që të njëjtin në mungesë të provave ta liroj nga akuza.

I akuzuari L.G në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, se me krye këtë vepër nuk e kemi kryer se po ta kishim kryer do ta kishim pranuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.G av. H.K në fjalën përfundimtare ka deklaruar përkitazi me aktakuzën e parashtruar nga prokuroria themelore departamenti për krime të rënda edhe kundër këtu të akuzuarit respektivisht të mbrojturit tim A.G pas mbajtjes së disa shqyrtimeve kryesore dhe administrimit të provave pretendimet e aktakuzës nuk janë provuar, gjatë dëgjimit të dëmtuarit A.T dhe dëshmitares së pretenduar B.Q nuk është arritur të vërtetohet shuma e saktë e gjendur në vendin e ngjarjes respektivisht qarkullimi nga shitja ditore, ku në disa deklarata dëshmitarja B. ka theksuar se janë gjendur një shumë tjetër nga shuma për të cilën më pastaj pronari respektivisht i dëmtuari A.T ka deklaruar, me këtë mënyrë nuk është administruar asnjë provë për të vërtetuar në mënyrë zyrtare nga administrata tatimore dhe arka fiskale për qarkullimin ditorë për ta vërtetuar shumën e saktë. Në fakte në këtë çështje penale është bërë shiqimi në vendin e ngjarjes respektivisht raporti i vendit të ngjarjes dhe foto albumit dhe për të cilën ne nuk kemi patur vërejtje dhe nuk e kontestojmë çështjen se është kryer grabitja nga personat të cilët qartë duken të maskuar edhe tre nën numër, por me administrimin e kësaj prove nuk është vërtetuar që ka marrë pjesë edhe i akuzuari këtu i mbrojturi im A.G, andaj bazuar me gjithë këtë që u tha me lartë nga provat të cilat janë gjendur dhe janë administruar në këtë çështje penale i mbrojturi im të lirohet nga aktakuza. Por duhet të theksoj nëse gjykata merr për bazë deklaratën të dhënë të mbrojturit tim në prokurori nga e cila rrjedhë se i njëjti të këtë kryere veprën penale ja jep besimin provave tjera të administruara në këtë çështje gjë që vlen të theksohet në momentin e dhënies së deklaratës në prokurori dhe unë vetë kamë qenë prezent ku prokurori i çështjes në përputhje me dispozitat të KPP-së, dhe konform tyre ka marrë deklaratën në mënyrë vullnetare nga i mbrojturi im andaj nëse gjykata gjen se i mbrojturi im është fajtorë për veprën penale për të cilën ngarkohet do të doja që ju si trup gjykues të keni parasysh dhe rolin e të mbrojturit tim në grupin e përbërë idetë eventuale të dhëna nga ky grup për këtë grabitje dhe veprimet konkrete të ndërmarra nga i mbrojturi im dhe duke i vlerësuar e gjithë këto të merren si rrethana lehtësuese në rastin e caktimit të vendimit mbi dënimin.

I akuzuari A.G në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, dhe njëherit shtonë se nuk e kemi kryer këtë grabitje se po ta kishim kryer do ta kishim pranuar.

Gjykata duke vlerësuar provat e administruara në procedurë, në pajtim me nenin 8 dhe nenin 361 të KPP-së, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se të akuzuarit J.G, L.G dhe A.G duke vepruar si anëtar të grupit me përdorim të forcës kanë përvetësuar pasurinë e luajtshme të personit tjetër me qëllim që ti sjellin vetës dobi pasurore të kundër ligjshme në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake në mes veti, me datën 16.02.2017 nga Peja me automjetin e tipit “Fiat Punto”, me ngjyrë hiri metalike pronë e Kompanisë Renta car “...”, vinë në Prizren dhe aty rreth orës 22:55 minuta, të maskuar me kapulaça të jakneve të vendosura në kokë, me shall të mbështejllura në fytyrë dhe me dorëza të holla të vendosur në duar, se bashku me shpejtësi hynë në barnatoren “...”, në rrugën “...” pn, në Prizren, i akuzuari J.G me grusht e then xhamin e recepturës (banaku), pastaj kalon përmbi banak të hapësira ku ishte e dëmtuara B.Q të

cilës ia kap flokët, ia merr nga dora telefonin celular dhe i thotë “ku janë paratë” dhe pasi ia tregon fiokën e dëmtuara, nga aty i merr me shpejtësi rreth 750 euro, i akuzuari L.G gjatë gjithë kohës ka pasur në dorë pistoletën të drejtuar kah e dëmtuara, ndërsa i akuzuari A.G në dorë e kishte satrën (sëpatën e vogël) duke qëndruar te dera e lokalit dhe vëzhguar situatën deri sa i akuzuari J.G i ka marrë nga fioka paratë e pastaj me shpejtësi që të tre ikin nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga deponimet e të dëmtuarës B.Ç. në cilësinë e dëshmitares, deponimet e dëshmitarit Sh.G, vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të “IPHONE 4S” të DRP-së në Pejë, vërtetimin mbi kthimin e gjësendeve – “IPHONE 4S” me ngjyrë të bardhë me numër të Imeit ... të lëshuar nga NJHR në Prizren me datën 21.02.2017, dëshmi kuponi me numër serik 0202199 për blerjen dhe afatin e garantimit të telefonit përkatës të datës 15.06.2016, raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes të njësisë së forenzikës të stacionit policor në Prizren me numër të dosjes 2017 – RVK – 86 te datës 22.02.2017, shiqimi i CD-së, deponimet e të akuzuarve dhënë në stacioni policor, prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor.

Dëshmitarja B.Ç. në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se në mbrëmje kritike te datës 16.02.2017 ka qenë se bashku me vëllaun e saj me të vogël duke punuar në barnatoren “...”, që është afër QKMF-së në Prizren, aty rreth orës 22:55 minuta, befasisht ka krisur dera e hyrjes së barnatores, ka parë personin e parë i cili ishte maskuar me shpejtësi e duke bërëtitur është afruar afër saj dhe e ka goditur xhamin e recepturës (banakut) të cilin e ka thyer pastaj ka hyp përmbi banak ka dalur nga ana e të dëmtuarës, në ato momente në anën e kundërt me një revole në dorë ishte po ashtu edhe një person tjetër i maskuar i cili e kishte drejtuar revolen ka e dëmtuara i cili i është drejtuar me fjalët mos lëviz ndërsa pak me larg nga e dëmtuara te dera e barnatores ishte po ashtu një person tjetër i maskuar me një sopat të vogël në dorë dhe për një moment personi i cili kishte hyrë brenda banakut afër të dëmtuarës i bërtiste ku janë paratë, e dëmtuara në gjendje afekti nuk i kujtohet se si e ka marrë telefonin në dorë për ta njoftuar pronarin e lokalit dhe personi i cili e theu gjamin menjëherë ia ka marrë prej dore telefonin, e ka kapur për flokë duke i thënë ku janë paratë dhe nga frika u dashtë mi ja tregua fiokën i cili e ka hapur fiokën ka marrë një sasi të hollash e pastaj në një fiokë tjetër i ka marrë disa aparate për sheqer, ka kërcyer përmbi banak dhe që të tre këta persona me shpejtësi janë larguar nga lokali. Fillimisht ka deklaruar se natën kritike janë vjedhur një telefon IPHONE 4S dhe 200 euro para, mirëpo të nesërmen pronari i barnatores dhe përgjegjësja kur e kanë kontrolluar barnatoren dhe sasinë e parave në fiokë kanë konstatuar se në fakt kishin marrë 765 euro, dhe disa aparate për matjen e sheqerit.

Gjykata duke analizuar deklaratën e të dëmtuarës dhënë në cilësinë e dëshmitares, gjykata në tërësi ia fal besimin kësaj deklaratë, deklarata përkon në tërësi me të gjitha shkresat e lëndës të cilat janë administruar si prova si dhe me shikimin e CD-së, dëshmitarja e ka përshkruar në tërësi rastin dhe në mënyrë të saktë i ka përshkruar veprimet e personave të maskuar që kanë kryer grabitjen natën kritike në barnatoren “...” në Prizren.

Dëshmitari Sh.G në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se data nuk me kujtohet por e di se kam qenë në kafe, në mëngjes duke shkuar në punë, mixha M. me J. kanë dalur për të blerë pleh për grurë, ndërsa dëshmitari Sh.G ka shkuar për në punë, fillimisht që të tre janë

dalë me pi kafe te kafe "...", pastaj ka ardhur një djalë i Shqipërisë i luti disa njerëz se a doni ta bleni një telefon pastaj erdhi dhe i luti edhe këta në tavolinë, mandej tha se a jeni të interesuar me marrë telefonin dëshmitari Sh. i ka thënë se jo, pastaj J. e këqyri i pëlqej dhe ia blejti telefonin, ai telefon kishte pasur kod dhe J. i ka thënë dëshmitarit pasi që ky telefon ka kod merre ti dhe hekja kodin, pastaj dëshmitari e ka marrë telefonin dhe është nisur për në punë dhe rreth orës 12 policia ka shkuar ne punë tek dëshmitari – Sh.G e kanë marrë atë dhe e kanë pyetur se ku e ke marrë këtë telefon, dëshmitari ka treguar se si ka ardhur deri te telefoni gjatë ditës ka patur bisedë me J. nga i cili është pyetur se ai i është hequr kodi i telefonit. Ky dëshmitar në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se me datën 17.02.2017 rreth orës 18:00 ka ardhur një shokë i vëllait tim J. i cili me tha se jepja këtë telefon J., telefoni ishte i modelit IPHONE 4 S ngjyrë e bardhë dëshmitari e ka marrë atë telefon dhe se atë natë nuk është takuar me J. te nesërmen e ka marrë telefonin me vete në punë dhe gjatë ditës ka biseduar në telefon me J. i cili e ka pyetur se ku e ke lenë telefonin dëshmitari është përgjigjur se telefonin e ka me vete duke kërkuar nga J. që t'ia shet telefonin, J. është pajtuar që t'ia shet për 40 euro, dëshmitari i është përgjigjur se kur ta marrë rrogën do ti jap 20 euro dhe me këtë gjë është pajtuar edhe J. unë nuk e di se ku e ka marrë J. telefonin.

Gjykata duke analizuar dëshminë e dëshmitarit dhënë në shqyrtim gjyqësor pjesërisht ia fal besimin kësaj dëshmie pasi që kjo dëshmi ka kundërthënë në mes dëshmisë së dhënë në Stacionin policor në Pejë dhe në shqyrtim gjyqësor. Gjykata ka pasur parasysh edhe faktin se ky dëshmitar është vëllai i të akuzuarit J. e L.G dhe djali i axhës i të akuzuarit A.G, gjatë dhënies së dëshmisë në shqyrtim gjyqësor ky dëshmitar nuk ka qenë i sigurtë dhe se e ka sajuar pjesën se si ka ardh deri te telefoni. Në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se telefonin IPHONE 4S e ka blerë nga një person i Shqipërisë ndërsa në dëshminë e dhënë pranë Stacionit Policor në Pejë ka theksuar se telefonin e ka marr nga një shok i J. dhe se ditën e nesërme ky telefon i është sekuestruar nga policia. Gjykata me këtë dëshmi ka vërtetuar se telefoni IPHONE 4S është gjetur tek ky dëshmitar nga i cili është sekuestruar nga policia dhe i është kthyer të dëmtuarës, kësaj pjese të dëshmisë gjykata ia fali besimin dhe se kjo pjesë e dëshmisë përkon edhe me deponimet e të akuzuarve dhe me provat materiale me të cilat është vërtetuar se telefoni është grabitur natën kritike nga i akuzuari J. në barnatoren "...” në Prizren.

Nga raporti i vërtetimit për sekuestrimin e përkohshëm të "IPHONE 4S" të DRP-së në Pejë, është vërtetuar se telefoni i vjedhur në natën kritike nga e dëmtuara B.Ç. "IPHONE 4S" me numër të Imeit ..., në vendin ku ka ndodhur edhe grabitja, ky fakt shihet edhe nga CD-ja, se të akuzuarit kanë grabitur një telefon nga e dëmtuara dhe se ky telefon është gjetur - sekuestruar nga Sh.G vëllai respektivisht djali i axhës i të akuzuarve.

Nga raporti i vërtetimit mbi kthimin e gjësendeve – "IPHONE 4S" me ngjyrë të bardhë me numër të Imeit ... të lëshuar nga NJHR në Prizren me datën 21.02.2017 është vërtetuar se telefoni i grabitur natën kritike i gjetur tek vëllai respektivisht djali i axhës së të akuzuarve, i është kthyer të dëmtuarës B.Ç. me datën 21.02.2017

Nga dëshmia - kuponi me numër serik 0202199 për blerjen dhe afatin e garantimit të telefonit përkatës të datës 15.06.2016, është vërtetuar se ky telefon i përket të dëmtuarës B.Q dhe se ky telefon është blerë nga ajo në shumë prej 150 euro dhe se ka patur garancion 30 ditë.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes të njësisë së forenzikës të stacionit policor në Prizren me numër të dosjes 2017 – RVK – 86 te datës 22.02.2017, është vërtetuar se me datën 16.02.2017 rreth orës 22:55 minuta, ka ndodhur një grabitje në barnatoren “...” në Prizren në rr “...” pn, njësi i krim teknikës ka dalur në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar se dera e lokalit ka qenë e hapur dhe e pa dëmtuar, brenda në lokal vëreheshin copa qelqi në dysHEME të lokalit dhe mbi shank (banak), është bërë fotografimi i lokacionit, lokalit nga ana e jashtme dhe brenda në tërësi. Nga këto foto shihen copa të qelqit të thyera nga grabitësit që përkon edhe me shiqimin e CD ku shihen veprimet e të akuzuarve fillimisht duke e thyer xhamin e banakut futet në banak duke e kapur për flokë të dëmtuarën nga ajo merr një telefon dhe më pastaj në arkë merr edhe disa të holla dhe largohen nga vendi ngjarjes.

Nga shikimi i CD-së, është vërtetuar se tre persona të maskuar hyjnë në barnatoren “...”, njëri nga ta me grusht then xhamin e shankut (banakut) futet në banak kap për floke të dëmtuarën nga ajo merr një telefon dhe pastaj drejtohet kah arka - fioku merr një shumë të hollave. Personi tjetër gjatë gjithë kohës shihet me revole në dorë të drejtuar kah e dëmtuara ndërsa personi tretë shihet qartë me një satër (sëpat të vogël) në dorë duke qëndruar afër derës dhe duke e vëzhguar situatën. Shikimi i CD-së përkon në tërësi me deklaratat e të akuzuarve J.G, L.G dhe A.G dhënë në Stacionin Policor në Pejë dhe në Prokurorinë Themelore në Prizren në prezencën e mbrojtësve të tyre dhe që të tre të akuzuarit i kanë pranuar veprimet inkrimuese të cilat i kanë ndërmarrë natën kritike.

I akuzuari J.G në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se me datën 16.02.2017 ka qenë në shtëpi, po atë ditë ka qenë në mal dhe ka marrë disa dru, në mal ka shkuar me L.in dhe me vëllain e vogël E.G, në Prizren nuk ka qenë asnjëherë, duke mohuar në tërësi kryerjen e veprës penale. I akuzuari në deklaratën e dhënë në prokurori në prezencën e mbrojtësit të tij avokatit F.J ka deklaruar se qëndrojmë në tërësi pranë deklaratës së dhënë pranë stacionit policor në Pejë e po ashtu në prezencën e mbrojtësit - avokatit Fatmir Ademaj. Në të dy deklaratat të dhënë si në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe në Stacionin policor në Pejë ka deklaruar se me rastin e grabitjes që ka ndodhur me datën 16.02.2016 rreth orës 23:00 në barnatoren “...” në Prizren, ku e përsëritë se atë ditë me vetiniciativë e ka marrë një automjet nga kompania “Renta Car”, të tipit “Fiat” në Pejë, ka shkuar te shtëpia e vetë në fshatin ... bashkë me vëllain L. dhe djalin e axhës A. është marrë veshë për me kryer ndonjë akt të grabitjes në Prizren. Diku në mbrëmje me automjetin në fjalë të cilin e ka drejtuar i akuzuari J.G kanë ardhë në Prizren kanë bërë një shëtitje dhe diku rreth orës 23:00 janë ndalur pranë një barnatore në Prizren, paraprisht janë maskuar në atë mënyrë që ka vendosur në kokë kapulaqin e jaknes dhe një shall në fytyrë, kurse vëllai L. së bashku me djalin e axhës A. edhe ata kanë vepruar si ky i akuzuar të cilët kanë pasur jakne i kanë vendosur kapulaqat e jaknes në kokë bashkë me shalla, e pastaj që të tre kanë vendosur në duar dorëza të holla dhe me shpejtësi kanë hyrë në barnatore, ku i pari ka qenë J. ndërsa pas tij ka qenë L. i me një pistoletë në dorë ndërsa A. e ka pasur një sopat të vogël qe e quajnë satër. Me të hyrë në barnatore ky i akuzuar (J.) e ka thyer xhamin e banakut të barnatores pastaj e ka kaluar banakun dhe ka hyrë brenda ku qëndronte e dëmtuara të cilës i ka thënë se ku janë paratë ajo është hamundur dhe aty afër në banakë e ka pasur telefonin të cilin ia merr i akuzuari J., i është ofruar të njëjtës e ka kapur lehtas për flokë ku përsëri i ka thënë ku janë paratë, e dëmtuara ka treguar se ku janë paratë në një fiokë, i ka marr dhe e dinë se kanë qenë rreth 325 euro, te cilat kanë qenë të

letrës e pastaj e ka kapërcyer banakun dhe që të tre me shpejtësi janë larguar nga vendi i ngjarjes. Thekson se duke u larguar prej barnatores e ka marrë me vete edhe një telefon mobil dhe kur është larguar nga barnatorja diku në një vend i ka gjuajtur shallat, kurse A. e ka gjuajtur satrën gjithashtu i kanë hudhur edhe dorëzat e holla të plastikës. Përndryshe vëllai i tij L. revolen ka vazhduar ta mbante me vete. Është vërtetë se para kësaj ngjarje ndoshta edhe pas kësaj ngjarje së bashku me djalin e axhës A., e besa me disa persona tjerë kanë kryer disa grabitje në Pejë dhe në Prishtinë, ku bile për një rast të grabitjes që kanë kryer në Prishtinë janë shpallur fajtorë nga gjykata e Prishtinës. I vie keq për këto raste që kanë ndodhur por edhe për rastin që ka ndodhur në Prizren, e dinë që ka vepruar keq e dinë që kjo nuk është arsye por kanë vepruar në këtë mënyrë për shkak të kushteve të vështira materiale ku bile edhe babën e ka të sëmur i cili nuk ka qenë në dijeni për këto veprime që kemi bërë ne.

I akuzuari L.G në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se në tërësi e mohon kryerjen e veprës penale, nuk qëndron në deklaratat të dhënë në Stacionin Policor në Pejë dhe në Prokurorinë Themelore në Prizren, veprimet të cilat i ka pranuar pranë Stacionit Policor në Pejë dhe në Prokurorinë Themelore në Prizren i ka pranuar nga frika. I akuzuari në deklaratën e dhënë në prokurori në prezencën e mbrojtësit të tij avokatit E.G ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë pranë stacionit policor në Pejë e po ashtu në prezencën e mbrojtësit - avokatit N.H. Në të dy deklaratat të dhënë si në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe në Stacionin policor në Pejë ka deklaruar se me datën 16.02.2017 jemi marrë veshë paraprakisht me vëllain J. dhe djalin e axhës A. me automjet kemi ardhë në Prizren diku në mbrëmje, janë marrë vesh që të grabisin ndonjë lokal dhe diku rreth orës 23:00 pasi janë maskuar duke i vendosur kapulaqat e jakneve në kokë, shallat në fytyrë dhe disa dorëza të holla në duar me shpejtësi kanë hyrë në barnatore ku ky akuzuar ka pasur një revole në dorë ndërsa djali i axhës e ka pasur një satër në dorë kurse vëllai J. i cili ka hyrë i pari i kujtohet se e ka thyer xhamin e tavolinës – banakut të barnatores e ka kapërcyer banakun i ka bërëtitur punëtores së barnatores që të tregoj se ku janë paratë, punëtoren e ka kapur për flokë pastaj ajo i ka treguar paratë me ç “rast vëllai J. i ka marrë 350 euro, dhe një telefon me ngjyrë të bardhë, pastaj me shpejtësi kanë dalur prej lokalit dhe dikund i kanë gjuajtur dorëzat dhe shallat. Përndryshe është vërtetë që kam pasur revole në dorë por ajo ka qenë e prishtë dhe me sa i kujtohet punëtores nuk iu është kërcënuar me armë e as A. nuk iu është kërcënuar asaj me satër përveç që i kanë mbajtur në duar që ta frigojn punëtoren e barnatores. Sa i kujtohet pasi kanë ikur prej lokalit djali i axhës A. dikund e ka hudhur satrën e pastaj me vonë me sa e dinë ky akuzuari vëllai J. telefonin që e kishte marrë nga barnatorja ja ka dhënë vëllait tjetër Sh., të cilin telefon në ndërkohë policia ia ka marrë Sh. dhe ja ka kthyer pronarit të barnatores. Është e vërtetë se kemi kryer disa vepra penale të grabitjes në Pejë dhe në Prishtinë, dhe për një rast të grabitjes që kanë kryer ky i akuzuar në Prishtinë është dënuar me burgim prej 4 vite, vëllai J. me 3.5 vite, ndërsa A. është dënuar po ashtu prej 3.5 vite. I vije keq për rastin që ka ndodhur, kemi vepruar në këtë mënyrë për ta mbajtur familjen edhe pse e dinë se kjo nuk është në rregull.

I akuzuari A.G në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se në tërësi e mohon kryerjen e veprës penale, nuk qëndron në deklaratat të dhënë në Stacionin Policor në Pejë dhe në Prokurorinë Themelore në Prizren, veprimet të cilat i ka pranuar pranë Stacionit Policor në Pejë dhe në Prokurorinë Themelore në Prizren, i ka pranuar nga frika. I akuzuari në deklaratën e dhënë në prokurori në prezencën e mbrojtësit të tij

avokatit H.K ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë pranë Stacionit Policor në Pejë e po ashtu në prezencën e mbrojtësit - avokatit B.C. Në të dy deklaratat e dhëna si në Prokurorin Themelore në Prizren dhe në Stacionin policor në Pejë ka deklaruar se me datën 16.02.2017 së bashku me djemtë të axhës J. dhe L.G kanë ardhur në Prizren për me shëtit dhe duke ecur rrugës në Prizren, kanë pirë birra dhe dikur në mbrëmje kanë mbetur pa para dhe aty për aty së bashku na ka lindur ideja për me grabitur ndonjë lokal dhe diku rreth orës 23:00 janë ofruar barnatores në Prizren, me shpejtësi kemi hyrë brenda i pari sa i kujtohet ka qenë J. e pastaj L. dhe në fund ka qenë ky i akuzuar, kanë qenë të maskuar me kapulaqa të jaknave në kokë, me shalla të mbeshtejullra në fytyrë në dorë kanë pasur disa dorëza të holla që i përdorin mjekët. Pasi që kanë hyrë në barnatore është e vërtetë që J. ka hypur mbi banak të barnatores, e ka thyer xhamin e pastaj ka zbritur poshtë te vendi ku ka qenë punëtorja e barnatores të cilës i ka thënë se ku janë paratë dhe të njëjtën e ka kapur për flokë, pastaj ajo i ka treguar fiokën se ku janë paratë, gjatë kësaj kohe është e vërtetë se ky i akuzuar ka qenë brenda në lokal me satër (sopat të vogël) në dorë, kurse L. ka pasur revole në dorë e cila ka qenë e prishtë me të vetmin qëllim që me frigue punëtoren por asaj nuk i jemi kërcënuar. Pasi J. i ka marrur paratë në shumën prej 300 e disa eurove, kanë ikur nga lokali dhe pasi kanë dalur në një ambient të hapur shallat dhe dorëzat që i kanë pasur i kanë gjuajtur kurse ky i akuzuar e ka gjuajtur edhe satrën – sopatën dikund por se ku e ka gjuajtur nuk e din. I kujtohet se pastaj paratë i kanë ndarë, ky i akuzuar i ka marrë 85 euro kurse vëllezërit në këtë rast J. me L. nuk e di ka sa i kanë marrë, mirëpo nuk është e vërtetë si që pretendohet se i kemi grabitur rreth 700 euro, telefonin më kujtohet se e ka marrë J. se kujt ja ka dhënë më vonë nuk e di. Me vie keq për rastin e ndodhur në Prizren e po ashtu edhe për rastet tjera që kanë ndodhur ku ka qenë ky pjesëmarrës për grabitje në Pejë dhe Prishtinë, për rastin e fundit që ka ndodhur në Prishtinë, me dt. 23.03.2017 së bashku me J. dhe L. jemi dënuar me nga 4 vite burgim.

Gjykata duke i analizuar mbrojtjet e të akuzuarve, dhënë në shqyrtim gjyqësor, në Stacionin Policor në Pejë dhe në Prokurorinë Themelore në Prizren. Kjo gjykatë gjene se mbrojtja dhënë në shqyrtim gjyqësor është në kundërshtim me të gjitha provat materiale dhe mbrojtët e tyre të dhënë në Stacionin Policor në Pejë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren, andaj edhe si të tillë e hudh si të pa bazuar duke mos ia falur besimin. Kjo gjykatë padyshim që ia falë në tërësi besimin deklaratave të dhënë pranë Stacionit Policor në Pejë dhe në Prokurorinë Themelore në Prizren, të cilat deklarata janë dhënë në prezencën e mbrojtësve të tyre në të cilat deklarata i kanë përshkruar në tërësi veprimet e tyre inkrimunuese. Që të tre të akuzuarit njëzëri kanë deklaruar se paraprakisht janë marrë vesh dhe me automjetin “Fiat” të marr nga Renta car “...” nga i akuzuari J. vinë në Prizren me qëllim të grabitjes së ndonjë lokali, me të ardhur në Prizren shkojnë në barnatoren “...” ku edhe kryejnë grabitjen e më pastaj largohen nga vendi i ngjarjes dhe diku në rrugë i hudhin shallat, i akuzuari A. hudh edhe sëpatën – satrën të cilën e kishte me veti. Këto deklarata janë në përputhje me provat materiale siç janë vërtetimi mbi sekuestrimin e telefonit IPHONE 4S me numër serik të lartpërmendur pronë e të dëmtuarës B.Ç., e i cili telefon është gjetur tek vëllai i të akuzuarit J. dhe L.G, i akuzuari J. ka theksuar se telefonin IPHONE 4S me numër serik të lartcekur ia ka dhënë vëllait të tij Sh.G. Edhe me provat tjera materiale padyshim që është vërtetuar se telefoni i konfiskuar nga dëshmitari Sh.G është pronë e të dëmtuarës B.Ç., i grabitur në natën kritike në barnatoren “...” dhe së fundmi ky telefon i është kthyer të dëmtuarës. Nga shikimi i CD-së shihen qartë veprimet e tre personave që kryejnë veprën penale të grabitjes dhe është në përputhje me mbrojtjen e të akuzuarve edhe pse të njëjtit kanë theksuar se për herë të parë e shohin këtë CD në

shqyrtim gjyqësor. Veprimet i përshkruajnë që të tre të akuzuarit njëzëri ashtu si në CD që i bie se deklaratat e dhëna në Stacionin Policor në Pejë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren në tërësi përkojnë me veprimet inkriminuese të tyre dhe padyshim që gjykata ia falë besimin këtyre deklaratave të cilat janë dhënë në prezencën e mbrojtësve të tyre. Mbrojtësit e të akuzuarve në fjalën përfundimtare kanë theksuar se të akuzuarit janë deklaruar vullnetarisht dhe të njëjtëve nuk iu është bërë presion nga askush, gjatë gjithë kohës mbrojtësit kanë qenë prezent gjatë marrjes së tyre në pyetje nga organet kompetente. Nga deponimet e të akuzuarve padyshim se është vërtetuar në tërësi teza e akuzës dhe veprimet e tyre inkriminuese.

Duke pasur parasysh se prokuroria ka bërë përshkrimin faktik në pikën I dhe II të aktakuzës duke i veçuar në dy dispozitiva veprimet e të akuzuarve. Gjukata pas administrimit të provave duke i vlerësuar veprimet e të akuzuarve ka ardhur në përfundim se të gjitha veprimet e të akuzuarve të përshkruhen në një përshkrim faktik pasi që të njëjtit me marrëveshje paraprake dhe duke vepruar si anëtar të grupit me qëllim të përftimit të kundërligjshëm kanë kryer veprën penale. Njëherit ka bërë edhe ndërrimin e paragrafëve në kualifikimin juridik të veprës penale dhe atë nga parag. 1 lidhur me parag. 3, në parag. 3 lidhur me parag. 1 të nenit 329 të KP-së, veprime që përkojnë me përshkrimin faktik dhe me kualifikimin juridik të veprës penale.

Gjukata nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, duke e analizuar secilën provë veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku në tërësi ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve J.G, L.G dhe A.G formohen të gjitha elementet e veprës penale të grabitjes nga neni 329 parag. 3 lidhur me parag. 1 të KP-së, në atë mënyrë që të akuzuarit me dashje dhe me vetëdije të plotë të vetëdijshëm për veprimet e veta kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen, andaj gjykata të njëjtit i ka shpallur fajtor dhe iu ka shqiptuar secilit veç e veç dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vitesh dhe secilit veç e veç dënimin gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penale juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat si ato rënduese dhe ato lehtësuese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarit ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, të cilët kanë vepruar si anëtar të grupit, të armatosur dhe të maskuar, peshën e veprës penale, e cila vepër ka rrezikshmëri të madhe, pasojat që iu kanë shkaktuar të dëmtuarve, të njëjtit janë recidivistë edhe më parë kanë kryer vepra penale të kësaj natyre dhe janë në vuajtje të dënimit për këto lloje të veprave penale, si rrethanë lehtësuese është marrë moshën e tyre e re, gjendja ekonomike e tyre, sjellja korrekte para gjykatës. Prandaj gjykata të akuzuarve iu shqiptoi dënimin me burg dhe dënimin me gjobë sepse konsideron se me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre penale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Në bazë të gjithë të cekurave më lartë, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve formohen elementet e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil juridiko civil, gjykata e bazoi në kuptim të nenit nenit 463 par.1 e 2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të lartë cekurat u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i krimeve të Rënda
PKR.nr.37/17 me datë 09.10.2017

Procesmbajtësja
Florije Kolukaj

Kryetari i trupit gjykues,
Artan Sejrani

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.